



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI QARKUT SHKODËR

### KRYETARI

### V E N D I M

**Nr. 1 Datë 08.04.2021**

### **PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA KOHE TË MANDATIT TË KESHILLTARIT TE QARKUT SHKODËR Z. SIMON DODA**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2021, në mbështetje të ligjit 139/2015 “për vetqeverisjen vendore” nenit 49 pika b) i ligjit, neni 75 pika c) dhe neni 77 pika j). Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, “për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19”, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 “për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...bazuar në Urdhërin nr.633 datë 17.11.2020 “për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura...”,

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, pas relatimit nga sekretaria e Këshillit të Qarkut dhe më pas diskutimit nga anëtarët e Këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **13 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

### **V E N D O S I:**

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit të qarkut Shkodër **Z. Simon Doda** si pasojë e humbjes së mandatit si anëtarë i Këshillit bashkiak Vau – Dejes, si rrjedhojë e doreheqjes se tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 150/4Prot.

Shkodër me 17.03.2021

### RELACION

### PËR PROJEKT -VENDIMIN

### PËR MBARIMIN E PARAKOHSHEM TË MANDATIT TË KËSHILLTARES TË QARKUT, SHKODËR Z. SIMON DODA.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49 pika b) i ligjit, neni 75 pika c) si dhe neni 77 pika j).

Pranë Këshillit të qarkut Shkodër është përcjellë shkresa zyrtare nr. Prot.578. Date:23.12.2020 nëpërmejt të cilës është depozituar Vendimi i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës nr.09 dt:25.02.2020. Me anë të të cilit është miratuar dorëheqja e anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës **Z. Simon Doda**. Bazuar në ligj si pasojë e humbjes së mandatit si anëtarë i Këshillit Bashkiak rrjedhimisht e humbet edhe mandatin si anëtarë i keshillit të qarkut Shkodër.

Si pasojë propozoj te shtohet ne rendin e dites se mbledhjes se KQSH-se edhe Projekt-vendimi per Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltarit të qarkut Shkodër z. Simon Doda si pasojë e humbjes së mandatit si anëtarë i këshillit bashkiak Vau – Dejes, kjo si pasojë e dorëheqjes se tij.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Edita SHOSHI